



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

VENDIM

Nr.62, datë 28.01.2025

PËR

“PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE QË DO TË NDIQEN NGA AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE, BREND A BREZIT BREGDETAR”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar; si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujtit”, e ndryshuar, me propozimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujtit,

VENDOSI:

1. Brenda brezit bregdetar, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të miratojnë leje zhvillimi/ ndërtimi/ prishje/ rikonstruksion/ riparime/ shtesa/ ndryshim projekti gjatë ndërtimit/ ndryshim të subjekteve zhvilluese dhe ndryshim i aktiviteteve/ funksioneve/ shtyrje afati dhe çdo leje tjetër të përmendur në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit, si dhe të kryejnë procedurat administrative për të gjithë aktet/dokumentet përkatëse, të parashikuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, deri në lëshimin e çertifikatës së përdorimit, vetëm për këto raste përjashtimore:
  - a) objekte të reja me sipërfaqe të përgjithshme deri në 250 m<sup>2</sup>;
  - b) rikonstruksionet e objekteve ekzistuese, leja për të cilat është dhënë nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit;
  - c) shtesa në objekte ekzistuese;
  - d) rrjetet e infrastrukturës publike vendore, rrjetet e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorura, që shtrihen brenda territorit të një njësie të vetëqeverisjes vendore;
  - e) objektet shtetërore në pronat shtetërore të transferuara tek njësítë e qeverisjes vendore;
  - f) objektet e dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, infrastruktura publike dhe/ose kritike, si dhe ndërtimet e reja në zonat e ndëmtuara nga fatkeqësia natyrore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.887, datë 24.12.2019.

- g) rrjetet e fibrave optike;
- h) muret rrethuese.
2. Autoritetet vendore të zhvillimit të territorit duhet të vijojnë procedurat në përputhje me kushtet dhe rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit, për të gjitha rastet e përmendura në pikën 1, për të cilat duhet të ndjekin procedurën e mëposhtme:
- a) autoriteti vendor i drejton Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektoronik të lejeve, kërkesën për marrjen e konformitetit, së bashku me dokumentacionin shoqëruar të poshtëshënuar:
    - i. Dokumentacioni i plotë i pronësisë;
    - ii. Planvendosja e objektit;
    - iii. Projekti arkitektonik.
  - b) Agjencia e Zhvillimit të Teritorit, i përgjigjet autoritetit vendor të zhvillimit të territorit, në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektoronik të lejeve, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga marrja e kërkesës përkatëse;
  - c) pas marrjes së njofimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për konformitetin e zhvillimit të propozuar, autoriteti vendor vijon procedurën për miratimin e lejes përkatëse.
3. Për të gjitha rastet e tjera, të cilat nuk përfshihen në pikën 1, të këtij vendimi, autoriteti kompetent vendimmarrës brezit bregdetar, është Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit.
4. Kërkesat për kryerjen e punimeve mbi bazën e një “deklarate paraprake për kryerjen e punimeve”, do të paraqiten dhe shqyrtohen pranë autoriteteve vendore të zhvillimit të territorit, me përashtim të kërkesave për stacione plazhi, të cilat janë objekt i një leje ndërtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit.”
5. Vendimi Nr. 23, datë 28.02.2020 i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit “Për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e aplikimeve, brenda zonës së brezit bregdetar”, shfuqizohet.
6. Ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi nga autoritetet përgjegjëse, si dhe të gjitha autoritetet e zhvillimit në nivel vendor, për ndjekien dhe zbatimin e tij.
7. Ky vendim pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGIJËS  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 11 / 04 2025